

**VENDIM**  
**Nr....., datë ..... 2019**

**PËR KUSHTET DHE NORMAT E PROJEKTIMIT TË BANESAVE TË  
SPECIALIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 58, pika 2, të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Çdo kusht apo standard projektimi për banesat e specializuara sipas programeve të parashikuara në ligjin nr. 22/2018 ‘Për strehimin social’ që nuk është parashikuar në këtë vendim, zbatohet në përputhje me kushtet dhe standardet e ndërtimit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
2. Norma e strehimit për banesat e specializuara është në përputhje me normën e strehimit në banesat sociale miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Banesat e specializuara ofrojnë infrastrukturë të përshtatur dhe të aksesueshme për të plotësuar nevojat funksionale, shëndetësore dhe të sigurisë fizike, sipas programit të banesave të specializuara të strehimit social për personat që kanë një nevojë specifike strehimi, përfshirë kategoritë e përcaktuara në nenin 58 pika 1 të ligjit nr. 22/2018 ‘Për strehimin social’.
4. Normat dhe kushtet e projektimit sipas këtij vendimi zbatohen nga çdo subjekt publik a privat që investon, blen ose disponon në pronësi banesa të specializuara.
5. Banesat e specializuara ndërtohen në zona që:
  - a. Janë të pastra nga ndotja e ajrit, ndotja e tokës apo forma të tjera që përbëjnë rreziqe shëndetësore, kërcënime dhe rreziqe natyrore ose njerëzore, sipas legjislacionit në fuqi mbi mbrojtjen civile, mbrojtjen e mjedisit dhe e cilësinë së ajrit në mjedis;
  - b. Janë të ekspozuara mirë ndaj rrezatimit diellor;
  - c. Nuk janë të ekspozuara ndaj zhurmave të shpeshta ose të vazhdueshme më të mëdha se 85 dB;
  - ç. Ofrojnë akses të automjeteve, furnizim me ujë dhe energji elektrike;
  - d. Mundësojnë lehtësisht akses në jetën komunitare, në shërbimet publike bazë dhe shmangin izolimin.

6. Ndërtesat e banesave të specializuara plotësojnë këto kushte:
  - a. Orientohen për të maksimizuar ekspozimin nga jugu dhe për të siguruar ajrosje tërthore;
  - b. Kur është e mundur, rekomandohet projektimi i terracave të gjelbra ose mbulesave të shfrytëzueshme si hapësirë sociale për banorët;
  - c. Lartësia minimale dysheme-tavan për hapësirat e banimit në njësitë e banimit nuk duhet të jetë më e vogël se 265 cm;
  - ç. Lartësia minimale dysheme-tavan për hapësirat e shërbimit dhe në bodrume nuk duhet të jetë më e vogël se 240 cm;
  - d. Duhet të ofrohet parkim për administratën dhe për vizitorët. Për banorët, vende parkimi për automjet apo për biçikleta duhet të ofrohen në varësi të rastit;
  - dh. Në banesat e specializuara për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara duhet të instalohen ashensorë të përshtatshëm për të transportuar karrige me rrota dhe /ose barela;
  - e. Banesat e specializuara duhet të ofrojnë ngrohjen dhe ftohjen e hapësirave, mundësisht përmes një sistemi qendror;
  - ë. Mbështjellësja e ndërtesës duhet të projektohet për të mundësuar që rrjedhja e ajrit të jetë minimale, rezistenca termike të jetë e lartë dhe të eliminohen urat termike, të maksimizojë përfitimin diellor gjatë dimrit dhe ta minimizojë atë gjatë verës;
  - f. Fasadat me orientim nga jugu dhe perëndimi, veçanërisht në zonat me verë të nxehtë, të jenë të pajisura me hijezues;
  - g. Të sigurojnë instalimin e paneleve diellorë për ngrohjen e ujit dhe paneleve fotovoltaike;
  - gj. Në sistemimet e jashtme të ndërtesave përdoren materiale të përshkueshme, në të cilat të paktën 20% e sipërfaqes së mjediseve të jetë e përshkueshme;
  - h. Sistemimet e mjediseve të jashtme të maksimizojnë sipërfaqet e gjelbra dhe natyrore dhe të minimizojnë materialet ndërtimore.
  
7. Banesat e specializuara, përmbushin të gjitha rregullat në fuqi në respektim të mjedisit, si dhe kushtet e mëposhtme:
  - a. Ato projektohen të orientuara në mënyrë të tillë që të përfitojnë nga ajrimi natyror dhe rrezatimi diellor, aty ku është e mundur të jenë të orientuara në dy drejtime të horizontit, dhe, të paktën një nga dhomat e banesës të ekspozohet ndaj rrezatimit diellor për të paktën dy orë në ditë, e matur në solsticin dimëror (20-23 dhjetor);
  - b. Rekomandohet përdorimi i materialeve të ndërtimit miqësore për mjedisin, si materiale të ricikluara, materiale lehtësisht të riciklueshme, materiale për prodhimin e të cilave shkaktohet impakt mjedisor minimal, materiale që mundësojnë kursim të lartë të energjisë, etj.;
  - c. Konsumi i energjisë duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për performancën e energjetike të ndërtesave;
  - ç. Përqendrimi i nivelit të radonit në mjediset e brendshme duhet të jetë sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi.

8. Disa njësi banimi në banesat e specializuara mund të organizohen në grupe që ofrojnë hapësira shtesë dhe shërbime të specializuara, në varësi të tipologjisë dhe strukturës, sipas përcaktimit në tabelën nr. 1. Kapaciteti maksimal i një banese të specializuar është 120 banorë, të cilët organizohen në grupe prej 8-30 banorë me shërbime të përshtatshme për secilin grup.
9. Njësia e banimit në banesat e specializuara mund të jetë një apartament ose një dhomë akomodimi, në varësi të tipologjisë së banesës dhe nevojave specifike të banorëve, sipas tabelës nr. 1. Njësitë e banimit mund të jenë pjesë e një banese të specializuar ose ato mund të jenë të vendosura brenda ndërtesave të zakonshme të banimit. Njësitë e banimit plotësojnë këto kushte:
- Një apartament duhet të përfshijë të paktën një hapësirë ndenje, ngrënie, gatimi, gjumi dhe banjë dhe, kur është e mundur një ballkon. Apartamentet mund të akomodojnë 1-6 banorë, në varësi të tipologjisë dhe strukturës së banesës së specializuar, sipas tabelës nr. 1;
  - Një dhomë akomodimi duhet të përfshijë të paktën një dhomë gjumi, një ballkon dhe një banjë. Dhoma mund të përdoret nga 1-2 banorë, në varësi të tipologjisë dhe strukturës së banesës së specializuar, sipas tabelës nr 1;
  - Banjat mund të ndahen mes banorëve të dy dhomave;
  - Zona e ndenjes, ngrënies dhe kuzhina /aneksi mund të përdoren bashkërisht nga banorët, në varësi të tipologjisë së banesës së specializuar dhe nevojave specifike sipas tabelës nr. 1.

Tabelë nr. 1: *Tipologjia, struktura dhe nevoja specifike të banorëve në banesat e specializuara*

Tipi i Banesës së Specializuar	Njësia	Nr. i Banorëve	Sipërfaqja Minimale Neto (m <sup>2</sup> )	Norma e numrit të banorëve për hapësira të përbashkëta	
Të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara	Dhomë	1	18	8-10 banorë me dhomë ndenje, aneks gatimi dhe hapësira ngrënie të përbashkëta.	
		2	22		
	Apartament	1	35		
		2	45		
Viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje	Dhomë	1	16	10-12 banorë me dhomë ndenje, aneks gatimi dhe hapësira ngrënie të përbashkëta. Në hapësirën e ngrënies shërbehet ushqim.	
		2	20		
	Apartament	1	30	10-20 banorë me hapësira të përbashkëta.	
		2	40		
		3	50		
		4	60		
		Dhomë	1	16	

Fëmijët pa kujdes prindëror		2	20	10-12 banorë me dhomë ndenje, aneks gatimi, hapësira ngrënie dhe hapësirë për studim të përbashkëta.
	Apartament	1	30	10-20 banorë me hapësira të përbashkëta dhe hapësirë për studim.
		2	40	
		3	50	
		4	60	
		5	70	
		6	80	
Vajzat nëna	Dhomë	1 +fëmijë	20	10-12 nëna me dhomë ndenje, aneks gatimi dhe hapësira ngrënie të përbashkëta.
	Apartament	1 +fëmijë	35	10-30 nëna me hapësira të përbashkëta

10. Kur banesat e specializuara funksionojnë si qendra të pavarura, në to parashikohen hapësira për shërbimet si vijon:

- a. Për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, përfshihen këto hapësira dhe kushte shtesë për njësitë e banimit dhe objektet:
  - i. Hapësirë për kujdes shëndetësor (minimumi 1 për 20 banorë),
  - ii. Hapësirë për fizioterapi,
  - iii. Hapësirë për ndihmën e parë,
  - iv. Hapësirë për infermieri,
  - v. Hapësira komunitare,
  - vi. Shtretërit përshtaten për pozicione të ndryshme. Zilet e alarmit duhet të jenë pranë çdo shtrati dhe në banjë,
  - vii. Për shtrimin e dyshemesë dhe pllakës së dushit duhet të përdoret material kundër rrëshqitjes,
  - viii. Ndërtesat respektojnë kërkesat e veçanta të aksesueshmërisë. Hyrjet dhe lëvizja brenda njësisë së banimit duhet të jenë të përshtatshme për karriget me rrota.
- b. Për viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje, përfshihen këto hapësira dhe kushte shtesë për njësitë e banimit:
  - i. Hapësirë për sigurinë dhe kontrollin,
  - ii. Hapësirë për përkujdes social,
  - iii. Hapësira komunitare,
  - iv. Hapësira për trajnim profesional,

- v. Në objekte, vëmendje e veçantë gjatë projektimit i kushtohet sistemeve të sigurisë dhe garantohet që objekti të jetë i aksesueshëm vetëm përmes hyrjeve të kontrolluara;
  - vi. Objekti duhet të ketë infrastrukturën e nevojshme për njoftimin e policisë, në raste rreziqesh ose emergjencash.
- c. Për fëmijët pa kujdes prindëror, përfshihen këto hapësira dhe kushte shtesë për njësitë e banimit:
- i. Hapësirë kujdestarie,
  - ii. Hapësirë për përkujdes psikologjik dhe social,
  - iii. Hapësira komunitare,
  - iv. Hapësirë studimi /bibliotekë,
  - v. Objekti duhet të ketë infrastrukturën e nevojshme për njoftimin e policisë, në raste rreziqesh ose emergjencash.
- ç. Për vajzat nëna, përfshihen këto hapësira shtesë për njësitë e banimit:
- i. Hapësira të specializuara për kujdes shëndetësor për nënën dhe fëmijën,
  - ii. Hapësirë për përkujdes psikologjik dhe social,
  - iii. Hapësira komunitare,
  - iv. Kënd lojërash për fëmijë.
11. Mjediset e ndërtimit dhe banesat sociale që përdoren për apo në kuadër të programeve të strehimit social të parashikuara në këtë vendim, sipas ligjit nr. 22/2019 'Për strehimin social' duhet të plotësojnë kushtet, normat dhe standardet e përcaktuara në këtë vendim. Banesat e specializuara ekzistuese që nuk përputhen me parametrat e këtij vendimi duhet të përshtaten gradualisht. Në çdo rast kur realizohen rinovime të banesave sociale ekzistuese, ato duhet të jenë në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë vendim. Në rastet kur banesat e specializuara ekzistuese përdoren për personat me aftësi të kufizuara, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose subjektet private mbajtëse të tagrës së pronësisë së tyre, me të ardhurat e veta dhe/ose me fonde nga buxheti i shtetit, financojnë realizimin e ndërhyrjeve të arsyeshme me qëllim:
- a. Përshtatjen e hyrjes në objekt;
  - b. Përshtatjen e hapësirave të lëvizjes;
  - c. Përshtatjen e hyrjeve në njësitë e banimit;
  - ç. Përshtatjen e hapësirave të tualetit dhe banjës;
  - d. Instalimin e ashensorit apo të pajisjeve për ngjitjen e shkallëve, nëse është e mundur.
12. Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

## RELACION

### **PËR PROJEKTVENDIMIN**

#### **PËR KUSHTET DHE NORMAT E PROJEKTIMIT TË BANESAVE TË SPECIALIZUARA**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektvendimi "Për kushtet dhe normat e projektimit të banesave të specializuara" propozohet në zbatim të nenit 58 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", me qëllim që të përcaktojë:

- a. normën e projektimit të banesave të specializuara,
- b. kushtet dhe normat e projektimit të banesave të specializuara.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi është në përputhje të plotë me ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", dhe programin politik të Këshillit të Ministrave për sa i përket politikës ekonomiko-sociale të shtetit shqiptar. Është i parashikuar të miratohet në katërmujorin e tretë të vitit 2019 në programin analitik të projektakteve për vitin 2019 miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 764, datë 27.12.2018 "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019", përkatësisht në pikën me titull "Për përcaktimin e kushteve, dhe normave të projektimit të banesave të specializuara", në referim të nenit 58 të ligjit nr. 22/2018. Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti janë përcaktimi i kushteve dhe normave të projektimit të banesave të specializuara, duke plotësuar kështu tërësinë e rregullave për normat, kushtet dhe standardet për banesat e strehimit social të rregulluara në kuadër të neneve 13, 21, 45 dhe 48 të ligjit nr. 22/2018 'Për strehimin social'. Projektakti që propozohet, në ndryshim nga parashikimet ligjore të neneve 13, 21, 45 dhe 48, kërkohet të hartohet në bashkëpunim me ministrinë e linjës, dhe si i tillë është hartuar dhe propozohet.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektvendimi "Për kushtet dhe normat e projektimit të banesave të specializuara" është një propozim i bazuar në ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social", përkatësisht në nenin 58 të tij. Projektvendimi qartëson kushtet dhe normat e projektimit vetëm të banesave të specializuara që

ndërrtohen në kaudër të një prej programeve të strehimit social sipas ligjit nr. 22/2018, duke u bërë kështu plotësues i kuadrit nënligjor të hartuar për normat, kushtet dhe standardet e banesave të strehimit social në vend. Projektakti sipas nenit 58 të ligjit nr. 22/2018 kërkohet të hartohet në bashkëpunim me ministritë e linjës. Konkretisht ky projektakt vjen si propozim i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Ky projektakt plotëson kuadrin ligjor të nevojshëm për zbatimin e ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” dhe ofrimin e rregullave të nevojshme për mbështetjen e nevojshme për grupe të caktuara në nevojë të shoqërisë.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 118 të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social".

- a. *Përputhshmëria e aktit të propozuar me nenin 100, pikën 1 dhe pikën 2 të nenit 118 të Kushtetutës:* Akti i propozuar propozohet nga organe kushtetuese (Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë) përpara një organi kushtetues (Këshilli i Ministrave), i cili ka tagrin të miratojë këtë akt (neni 100 i Kushtetutës). Bazuar në nenin 58 të ligjit 22/2018, jemi në kushtet e plotësisht të kërkesave kushtetuese të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës për nxjerrjen e akteve nënligjore për arsye se: (i) ligji material përcakton organin publik i cili ka tagrin të urdhërojë nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor (Këshilli i Ministrave), (ii) ligji i cili shërben si bazë ligjore e aktit të propozuar autorizon në mënyrë të shprehur nxjerrjen e aktit nënligjor (iii) ligji parashikon çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të të cilave nxirret akti i propozuar.

*Përputhshmëria e aktit të propozuar me qëllimin e dispozitës përkatëse të ligjit, në funksion të propozimit:* Ligji për strehimin social ka të përcaktuara qartë edhe modalitetet që duhet të plotësojë akti sa i takon qëllimit të propozimit. Konkretisht, neni 58 i ligjit nr. 22/2018 parashikon miratimin e një vendimi të Këshillit të Ministrave “[p]ër përcaktimin e kushteve, dhe normave të projektimit të banesave të specializuara”. Çështjet e këtij neni adresohen plotësisht në titull dhe në përmbajtjen e projektaktit.

- b. Bazuar në këtë parashikim të ligjit, Ministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, propozojnë aktin përpara organit që ligji ka autorizuar, Këshillit të Ministrave.



- c. *Përputhshmëria e aktit me legjislacionin ndërkombëtar*: Akti nuk lidhet drejtpërdrejt me ndonjë akt ndërkombëtar, por në kuadrin e përgjithshëm është përgatitur në përputhje me aktet ndërkombëtare të ratifikuara apo në të cilat aderon vendi ynë si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 25/1), Konventa për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe veçanërisht Rekomandimet e Përgjithshme 4 (1991) dhe 7 (1997) apo Rekomandimi i Përgjithshëm 16 i Kombeve të Bashkuara për strehim të përshtatshëm, Konventa Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, etj.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektvendim nuk ka si objektiv të përafrohet me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi propozohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, në kuadër të zbatimit të politikës së qeverisë shqiptare në fushën e strehimit social, me qëllim përcaktimin e kushteve dhe normave të projektimit të banesave të specializuara.

Kushtet dhe normat e projektimit të banesave të specializuara të paraqitura në projektvendim nuk synojnë të ofrojnë një normativë të plotë dhe shteruese; ato propozojnë kriteret dhe çështjet bazë të projektimit që duhet të zbatohen për të garantuar strehim të përshtatshëm social për kategori të posaçme individësh. Premisa në bazë të së cilës është hartuar ky projektvendim është që të paraqitet si rregullues i atyre aspekteve, të cilat politikëbërësi synon t'i adresojë në mënyrë të posaçme për rastet e strehimit social, duke ruajtur edhe për ndërtimet sociale të njëjtat parametra, kushte e standarde si për ndërtimet në përgjithësi. Projektvendimi i propozuar nuk synon të adresojë çështje si ajo e sigurisë nga zjarri dhe aksesit për personat me aftësi të kufizuara, pasi ato adresohen përkatësisht në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 626, datë 17.5.2015 dhe nr. 1503, datë 19.11.2008. Gjithashtu, çështjet e lidhura me konsumin e energjisë dhe nivelet e lejueshme të radonit në to adresohen përkatësisht nga ligji nr. 116/2016 dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 957, datë 19.12.2015. Projektvendimi përqendrohet në karakteristikat arkitektonike të ndërtesave dhe banesave dhe jo në aspekte të lidhura me sistemet strukturore, elektrike, hidraulike dhe mekanike. Në të njëjtën kohë, projektvendimi ofron një sërë parametrash të reja që bazohen në dhe reflektojnë konceptet e përshtatshmërisë dhe qëndrueshmërisë. Siç u theksua, për çdo kriter, parametër apo normativë që nuk përshkruhet në projektvendim, referenca është tek legjislacioni ekzistues. Tërësia e çështjeve që janë identifikuar për rregullim të posaçëm është qartësuar në vijim.

Projektvendimi është i strukturuar në 12 pika. Pika 1 qartëson natyrën e aktit si një akt nënligjor plotësues i kushteve apo normave të projektimit të parashikuara nga legjislacioni dhe se cilido kusht, normë apo standard që nuk është parashikuar në këtë projektvendim, zbatohet në përputhje me normat, kushtet teknike apo standardet e ndërtimit të përgjithshme për banesat sociale dhe ato të përgjithshmet për banesat, në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Projektakti, sipas pikës 2, nuk parashikon asnjë ndryshim lidhur me normën e strehimit të banesave të specializuara krahasuar me ato të banesave të strehimit social në përgjithësi, duke siguruar kështu barazi trajtimi të gjitha kategorive që përfitojnë nga programet e ligjit për strehimin social.

Pikat 5 deri 7 përcaktojnë kushte të projektimit të përshtatura sipas programit të banesave të specializuara të strehimit social për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje, fëmijët pa kujdes prindëror, vajzat nëna, lidhur me zonat ku mund të projektohen banesat e specializuara si dhe vetë banesat. Së pari, projektakti kërkon zona me ajër të pastër, që mundësojnë ajrosje tërthore, pa rreziqe natyrore ose njerëzore, me ekspozim të mirë ndaj rrezatimit diellor, jo me ekspozim më të madh ndaj zhurmave se 85 dB, që ofron akses të automjeteve, të mundësojnë furnizim me ujë dhe energji elektrike, si dhe në jetën komunitare, shërbimet publike bazë dhe shmangin izolimin social të familjeve që strehohen në to. Gjithashtu, disa prej kushteve specifike që parashikohen lidhur me vetë ndërtimet, përfshijnë lartësinë minimale dysheme-tavan për hapësirat e banimit në njësitë e banimit jo më të vogël se 265 cm dhe për hapësirat e shërbimit dhe në bodrume jo më të vogël se 240 cm, ndërtimi të ketë parkim për banorët dhe vizitorët, terraca të gjelbra ose mbulesa të shfrytëzueshme si hapësirë sociale për banorët kur është e mundur, sipërfaqet e jashtme të maksimizojnë sipërfaqet e gjelbra dhe natyrore dhe të minimizojnë materialet ndërtimore, për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara të instalohen ashensorë të përshtatshëm për të transportuar karrige me rrota dhe /ose barela, të kenë ngrohje dhe ftohje mundësisht përmes një sistemi qendror të hapësirave, fasadat të jenë me orientim nga jugu dhe perëndimi, veçanërisht në zonat me verë të nxehtë, të jenë të pajisura me hijezues, të kenë panele diellore për ngrohjen e ujit dhe panele fotovoltaike, mbështjellësja e ndërtesës të projektohet për të mundësuar që rrjedhja e ajrit të jetë minimale, rezistenca termike të jetë e lartë dhe të eliminohen urat termike, të maksimizojë përfitimin diellor gjatë dimrit dhe ta minimizojë atë gjatë verës, dhe në sistemimet e jashtme të ndërtesave të përdoren materiale të përshkueshme, në të cilat të paktën 20% e sipërfaqes së mjediseve të jetë e përshkueshme. Gjithashtu, projektakti në respektim të rregullave ndaj mjedisit, parashikon disa kushte sia to të lidhura me përfitimin sa më shumë të dritës së diellit, përdorimit të materialeve të ndërtimit miqësore për mjedisin, konsumit të energjisë në përputhje me legjislacionin në fuqi për performancën e energjetike të ndërtesave, si dhe përqendrimin e nivelit të radonit në mjediset e brendshme sipas legjislacionit në fuqi.

Projektakti kërkon që, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, edhe mjediset e ndërtimit dhe banesat sociale aktuale të specializuara të plotësojnë kushtet dhe normat e përcaktuara në të, dhe në rastet kur nuk janë të tilla, të përshtaten gradualisht. Projektakti i kushton vëmendje të posaçme

rasteve kur banesat e specializuara ekzistuese përdoren për personat me aftësi të kufizuara duke parashikuar që mbajtësit e së drejtës së pronësisë së tyre të financojnë realizimin e ndërhyrjeve të arsyeshme me qëllim përshtatjen e hyrjes në objekt, hapësirave të lëvizjes, hyrjeve në njësitë e banimit, hapësirave të tualetit dhe banjës si dhe instalimin e ashensorit apo të pajisjeve për ngjitjen e shkallëve, nëse është e mundur.

Pika 12 përcakton institucionet apo strukturat e ngarkuara me zbatimin e këtij projektakti. Në fund parashikohet, në përputhje me Kushtetutën, se hyrja në fuqi e aktit është pas botimit në Fletore Zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Me zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin, instituti publik i strehimit social dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektvendim u hartua në kuadrin e një bashkëpunimi midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) si ministria përgjegjëse për strehimin dhe UNDP-së, me asistencën e ekspertëve kombëtarë të kontraktuar nga UNDP-ja mbështetur në procedurat e UNDP-së.

Pranë MFE-së u ngrit grupi i punës me anëtarë nga stafi i MFE-së i cili diskutoi intensivisht dhe konsultoi projektaktin në takime të vazhdueshme dhe periodike. Draftet e përgatitur nga ekspertë u rishikuan disa herë në takime të përbashkëta të grupit të punës për të pasqyruar në të çdo problematikë të ndeshur në praktikën e deritanishme. Në vijim, drafti u dakordësua me ministrinë bashkëhartuese. Grupi i punës dhe ekspertët analizuan edhe aktet nënligjore përkatëse që kanë mbuluar rregullimet e këtij projektvendimi për të konstatuar nga pikëpamja historike zhvillimin e rregullimit ligjor.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Zbatimi i ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social” përcjell kosto shtesë financiare për të gjitha programet, një pjesë e të cilave do të përballohen nga buxheti qendror dhe nga buxheti i njësisve të vetëqeverisjes vendore.

Lidhur me kostot institucionale, projektvendimi nuk kërkon ndryshim të numrit të të punësuarve pranë njërive të vetëqeverisjes vendore apo institucioneve të qeverisjes qendrore të ngarkuara me zbatimin e këtij vendimi.

### **PROPOZUESIT**

**Anila Denaj**  
**Ministër i Financave**  
**dhe Ekonomisë**

**Ogerta Manastirliu**  
**Ministër i Shëndetësisë**  
**dhe Mbrojtjes Sociale**

**Belinda Balluku**  
**Ministër i Infrastrukturës**  
**dhe Energjisë**

.....